

Kualifikimet e Organeve
Drejtuese

Këshilli Drejtues:

Marie Valerie Brunner	- Kryetare
Heinz Eiedner	- Zëvendëskryetar
Edzard Janssen	- Anëtar
Petro Merkulov	- Anëtar
Thomas Matejka	- Anëtar

Curriculum vitae

Marie Valerie Brunner

1. Edukimi

1978-1986	Gjimnazi Sacre-Coeur, Vjenë
1986-1991	Universiteti i Ekonomisë dhe Biznesit në Vjenë, Master në Ekonomi Ndërkombëtare
2012	Master në Administrim Biznesi Ekzekutiv, Program i Menaxhimit të Avancuar, Francë
2020- në vazhdim	Universiteti Sigmund Freud në Vjenë

2. Përvoja

Nëntor 2023 – deri tani	Raiffeisen Bank International AG Anëtare Bordi për Marrëdhëniet me Klientët Korporatë dhe Institucionet Financiare
2019 - 2023	Raiffeisen Bank International AG Drejtore e Divizionit të Klientëve Institucione Financiare
2016 - 2019	Raiffeisen Centrobank, AG Tegetthoffstraße 1 Anëtare Bordi, CRO/CFO, Operacionet e TI-së
2011 - 2015	Raiffeisenbank International AG Drejtore e Departamentit për Klientët Korporata Globale
2005 - 2010	Raiffeisen Zentral Bank Österreich AG Drejtore e Departamentit për Marrëdhëniet me Klientët Korporata Austriake
1991 - 2005	Raiffeisen Zentralbank Österreich AG Në vitin 1991 Valerie Brunner filloi karrierën e saj në Raiffeisen Zentralbank AG në Divizionin e Klientëve Korporata Austriake.

Heinz Eiedner

1. Edukimi

1976 Diplomë në Administrim Biznesi
Universiteti Graz, Austri

2. Përvoja

2019 – deri tani	Raiffeisen Bank sh.a., Shqipëri Zëvendëskryetar i Këshillit Drejtues
2019 – deri tani	Raiffeisen Bank sh.a., Shqipëri Kryetar i Komitetit të Kontrollit
2011 - 2017	Raiffeisenbank Zrt., Hungari Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisenbank Zrt., Hungari
2001 - 2010	Raiffeisen Bank International, Austri Anëtar Bordi dhe Drejtor i Operacioneve
1995 - 2001	Raiffeisen Zentralbank, Austri Drejtor i Shërbimeve të Transaksioneve
1993 - 1995	Raiffeisen Zentralbank, Austri Drejtor i Shërbimit të Pagesave
1988 - 1993	Citibank, Londër Drejtor i Menaxhimit të Produktit – Shërbimet e Menaxhimit të Cash-it
1986 - 1988	Citicorp Latino, Miami Florida Drejtori i Biznesit të Informacionit për Amerikën Latine
1983 - 1986	Citibank Buenos Aires Drejtor i Operacioneve dhe Teknologjisë për Divizionin SARP
1979 - 1983	Citibank Bruksel Menaxher Projekti për Zhvillimin e Sistemit & Implementimin
1977 - 1979	Citibank Austri Stazhier, Drejtor i Departamentit të Kontrollit Financiar & Drejtor i Automatizimit

Edzard Janssen

1. Edukimi

1975-1985	Gjimnazi i Papenburgut (Certifikatë e përgjithshme arsimi)
1987-1994 e	Master në Shkencat Humane, Universiteti i Bonn-it (përfshirë Universitetin Kumamotos, 1 vit/ Japoni)

2. Përvoja

03/2011 – deri tani	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Prokurimeve, Kontraktimeve të Palëve të Treta & Menaxhimit të Pronave të Paluajtshme për Grupin
02/2009 – 03/2011	Tatra Banka, Bratislava (Slovakia) Drejtor I Menaxhimit të Materialeve.
06/2005 - 12/2008	T-Systems Business Services, Bonn (Gjermani) Drejtor i Prokurimeve dhe Logjistikës
04/2004 - 05/2005	Deutsche Telekom AG, Bonn (Gjermani) Drejtor I Menaxhimit të Prokurimeve Globale
02/2001 - 03/2004	Slovak Telekom, Bratislava (Slovakia) Drejtor i Prokurimit, Logjistikës dhe Menaxhimit të Automjeteve
08/1999 - 01/2001	Deutsche Telekom AG, Bonn (Gjermani) Prokurimet e Grupit Menaxher
08/1998 – 07/1999	Deutsche Telekom, Azi (Singapore) Prokurimet Ndërkombëtare Menaxher i Projekteve
10/1997 - 07/1998	Deutsche Telekom, Tokio (Japoni) Suport për Prokurimet Menaxher i Projekteve
1994 - 1996	Instituti Gjerman për Studime Japoneze, Tokio (Japoni) Instituti Kërkimor i Ministrisë Gjermane për Shkencën dhe Teknologjinë Bashkëpunëtor Kërkimor, Studime mbi tregun Japonez të Telekomunikacionit

Petro Merkulov

1. Edukimi

2001	Diplomë Bachelor në Ekonomi, Akademia Kombëtare Metalurgjike e Ukrainës
2002	Master në Ekonomi, Akademia Kombëtare Metalurgjike e Ukrainës
2005	Master në Administrim Biznesi Menaxhim Financiar, Universiteti i Shkencave të Aplikuara, Coburg, Gjermani

2. Përvoja

05/2022 - deri tani	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Divizionit të Produkteve për Klientët Individë
08/2021 – 05/2022	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Divizionit për Huadhënien Ndërkombëtare
08/2017 – 08/2021	Raiffeisen Bank International AG, Austri Menaxher i Produktit të Huadhënies për Biznesin Retail
09/2009 – 05/2017	ZUNO Bank AG Am Stadtpark Vjenë Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut
08/2005 – 09/2009	Raiffeisen Bank International AG, Austri Menaxher i Rrezikut, Departamenti i Rrezikut Retail
11/2004 – 03/2005	Deutsche Bank, München, Gjermani Specialist Finance në Departamentin e Shërbimeve të Menaxhimit të Rrezikut

Thomas Matejka

1. Edukimi

10/2002 – 03/2007	Administrim i Biznesit Ndërkombëtar; Universiteti i Ekonomisë dhe Administrimit të Biznesit, Vjenë
11/2010 – 09/2012	Master Profesional “Administrim Biznesi në Sektorin Bankar” Akademia Ekzekutive EÛ, Vjenë

2. Përvoja

10/2021 - deri tani (Ukrainë)	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor Ekzekutiv i Financës, Anëtar i Bordit Drejtues, Raiffeisen Bank Aval
06/2019 - 10/2021	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Divizionit të Institucioneve Financiare, Menaxhimit të Rrezikut të Vendit dhe Portofolit
03/2018 – 05/2019	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut të Institucioneve Financiare- Financës Tregtare dhe Eksportit
06/2014 – 02/2018	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut të Integruar
11/2011 – 05/2014	Raiffeisen Bank International AG, Austri Përgjegjës i Njesisë së Analizës së Rrezikut të Integruar
04/2011 – 10/2011	Raiffeisen Bank International AG, Austri Menaxher i Rrezikut të Likuiditetit
06/2007 – 03/2011	Raiffeisen Bank International AG, Austri Kryeanalist i Portofolit të Kredisë

Komiteti i Kontrollit

Heinz Eiedner - Kryetar
Alda Shehu -
Zëvendëskryetare Thomas Matejka
- Anëtar

Heinz Eiedner

1. Edukimi

1976 Diplomë në Administrim Biznesi
Universiteti Graz, Austri

2. Përvoja

2019 – deri tani	Raiffeisen Bank sh.a., Shqipëri Zëvendëskryetar i Këshillit Drejtues
2019 – deri tani	Raiffeisen Bank sh.a., Shqipëri Kryetar i Komitetit të Kontrollit
2011 - 2017	Raiffeisenbank Zrt., Hungari Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisenbank Zrt., Hungari
2001 - 2010	Raiffeisen Bank International, Austri Anëtar Bordi dhe Drejtor i Operacioneve
1995 - 2001	Raiffeisen Zentralbank, Austri Drejtor i Shërbimeve të Transaksioneve
1993 - 1995	Raiffeisen Zentralbank, Austri Drejtor i Shërbimit të Pagesave
1988 - 1993	Citibank, Londër Drejtor i Menaxhimit të Produktit – Shërbimet e Menaxhimit të Cash-it
1986 - 1988	Citicorp Latino, Miami Florida Drejtori i Biznesit të Informacionit për Amerikën Latine
1983 - 1986	Citibank Buenos Aires Drejtor i Operacioneve dhe Teknologjisë për Divizionin SARP
1979 - 1983	Citibank Bruksel Menaxher Projekti për Zhvillimin e Sistemit & Implementimin
1977 - 1979	Citibank Austri Stazhier, Drejtor i Departamentit të Kontrollit Financiar & Drejtor i Automatizimit

Alda Shehu

1. Edukimi

1996 - 2000 Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Financës

2018	BA në Financë dhe Kontabilitet, Universiteti INSEAD Certifikatë në “Strategjinë në Epokën e Ndryshimit Digjital”
2003 – deri tani	Shoqata e Kontabisitëve të Certifikuar Kontabilist i certifikuar (FCCA)
2025 – deri tani	Shoqata e Specialistëve të Thesarit për Korporatat, Mbretëri e Bashkuar Specialist i Thesarit i certifikuar i korporatave

2. Përvoja

2022 - deri tani	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor e Kontabilitetit dhe Metodologjisë Financiare të Grupit
2020 - 2022	Raiffeisen Bank sh.a. Drejtor e Departamentit të Strategjisë dhe Inovacionit
2004 - 2020	Raiffeisen Bank sh.a. Drejtor e Divizionit të Financës
1999 - 2004	Deloitte, Shqipëri & Kosovë Menaxhere e Auditit
2000 – 2001	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Administrimit të Biznesit Pedagoge për Menaxhimin e Kostove

Thomas Matejka

1. Edukimi

10/2002 – 03/2007	Administrim i Biznesit Ndërkombëtar; Universiteti i Ekonomisë dhe Administrimit të Biznesit, Vjenë
11/2010 – 09/2012	Master Profesional “Administrim Biznesi në Sektorin Bankar” Akademia Ekzekutive EU, Vjenë

2. Përvoja

10/2021 - deri tani (Ukrainë)	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor Ekzekutiv i Financës, Anëtar i Bordit Drejtues, Raiffeisen Bank Aval
06/2019 - 10/2021	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Divizionit të Institucioneve Financiare, Menaxhimit të Rrezikut të Vendit dhe Portofolit
03/2018 – 05/2019	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut të Institucioneve Financiare- Financës Tregtare dhe Eksportit

06/2014 – 02/2018	Raiffeisen Bank International AG, Austri Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut të Integruar
11/2011 – 05/2014	Raiffeisen Bank International AG, Austri Përgjegjës i Njesisë së Analizës së Rrezikut të Integruar
04/2011 – 10/2011	Raiffeisen Bank International AG, Austri Menaxher i Rrezikut të Likuiditetit
06/2007 – 03/2011	Raiffeisen Bank International AG, Austri Kryeanalist i Portofolit të Kredisë

Drejtoria/Bordi Drejtues

Christian Canacaris - Drejtori i Përgjithshëm

Z. Christian Canacaris është Drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank në Shqipëri që prej muajit tetor 2010.

Z. Canacaris është një bankier me një përvojë mjaft të gjerë. Ai ka punuar për shumë vite në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe tregjet në zhvillim në pozicionin e Anëtarit të Bordit. Z. Canacaris ka një karrierë të gjatë në fushën e Thesarit dhe Tregjet e Kapitalit.

Z. Canacaris iu bashkua Raiffeisen Bank në prill të vitit 2004 si Anëtar Bordi për Thesarin, Bankingun e Investimeve dhe Tregjet e Kapitalit. Gjatë periudhës shkurt 2010-tetor 2015 ai ka qenë gjithashtu përgjegjës për Bankingun e Korporatave në nivel bordi.

Gjatë karrierës së tij të gjatë bankare ai ka mbajtur pozicione menaxheriale në RZB Krekova Bank, Raiffeisen Bank Maribor Sloveni, në Raiffeisen Bank Rumani, Bankën Kombëtare të Greqisë S.A, Bukuresht, Rumani, në Bankën Kombëtare të Greqisë S.A, Paris, në Phoenix Bank, Paris, etj.

Z. Canacaris është diplomuar në Universitetin e Parisit, Pantheon-Sorbonne, për Financa Evropiane dhe të Ndërmarrjeve. Ai ka një master në Ekonometri, Matematikë dhe Statistikë, si edhe një Master në Menaxhim dhe Administrim Biznesi nga “Manchester Business School”.

Alexander Zsolnai - Zëvendësdrejtör i Përgjithshëm

Alexander Zsolnai iu bashkua Raiffeisen Bank në mars 2010 si Anëtar Bordi për Financën dhe Riskun. Ai është emëruar Zëvendësdrejtör i Përgjithshëm/Zëvendëskryetar i Bordit Drejtues që prej 1 tetorit 2010 krahas pozicionit si Drejtör Ekzekutiv për Financën dhe Riskun.

Z. Zsolnai ka një përvojë të gjerë bankare dhe ekzekutive. Ai mbajtur pozicionin e Anëtarit të Bordit Drejtues dhe Drejtör Ekzekutiv për Financën dhe Riskun në Raiffeisen Bank Bosnja & Hercegovina d d Sarajevë, Drejtör Ekzekutiv të HVB- Central Profit, Banka d.d., Sarajevë dhe Këshilltarit të Lartë për rajonin e Evropës Juglindore për krijimin e kontrollit të shitjeve rajonale, Drejtör të Zhvillimit të Rrjetit të Degëve në rrjetin e degëve të divizionit të biznesit (organizatë e menaxhimit të përbashkët me PSK/Austrian Post Bank), etj.

Z. Zsolnai është diplomuar në Universitetin e Vjenës për Administrim Biznesi dhe ka disa kualifikime në zhvillimin strategjik dhe operativ të tregjeve të reja / fushat e biznesit, hartimin dhe zbatimin e proceseve të ndryshimit dhe atyre inovative, zhvillimin e kanaleve të shitjes, veçanërisht rrjetet e degëve, proceset dhe organizimin e menaxhimit të riskut, menaxhimin e njerëzve dhe organizatave, veçanërisht në një mjedis kompleks, etj.

Elona Mullahi (Koçi) - Anëtare Bordi për Biznesin me Korporatat

Znj. Mullahi (Koçi) është Anëtare Bordi për Biznesin me Korporatat që prej muajit tetor 2015. Ajo ka një përvojë mbi 21-vjeçare në sistemin bankar dhe njohuri të thella në biznesin e Korporatave dhe atë të ndërmarrjeve të vogla, riskun e kredisë, si dhe funksione të tjera biznesi dhe mbështetëse në industrinë bankare.

Nga viti 2004, vit në të cilin iu bashkua Raiffesien Bank, deri në vitin 2009 Znj. Mullahi (Koçi) ka drejtuar Departamentin e Institucioneve Publike, Qeverisjes Qendrore dhe Lokale. Ndërsa që nga viti 2010, ka drejtuar segmentet e biznesit që përfshijnë korporatat vendase dhe ato ndërkombëtare, bizneset e vogla, si dhe të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale, institucione të tjera të sektorit publik, institucione financiare, (psh. institucione financiare jo-banka, kompani sigurimi, brokera si dhe kompani leasing), si dhe OJQ.

Gjithashtu, Znj. Mullahi (Koçi) ka një përvojë të gjatë dhe ka punuar në pozicione menaxheriale edhe në Bankën Amerikane të Shqipërisë, Bankën Kombëtare të Greqisë, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrinë e Financave, etj.

Elona Mullahi (Koçi) mban gjithashtu pozicionin e Anëtares së Komitetit të Kredisë të Bankës. Ajo ka mbajtur gjithashtu pozicionin e Anëtares së Këshillit të Administrimit të Raiffeisen Leasing që nga viti 2010 deri në 2015, si edhe pozicionin e Anëtares së Këshillit të Administrimit të Raiffeisen Invest nga viti 2011 deri në vitin 2014.

Erion Serti - Anëtar Bordi për Teknologjinë e Informacionit dhe Operacionet

Z. Erion Serti është Anëtar i Bordit Drejtues për Teknologjinë e Informacionit dhe Operacionet që nga 1 janari 2022.

Z. Serti ka një përvojë të gjatë në Raiffeisen Bank në Shqipëri që nga viti 2004. Gjatë rrugëtimit të tij në Raiffeisen Bank në Shqipëri ai ka menaxhuar me sukses disa pozicione drejtuese në sektorin e TI-së, si Drejtor i Departamentit të Sistemeve dhe Zbatimit, Drejtor i Operacioneve të TI-së dhe nga viti 2018 – 2021 ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Divizionit të TI-së.

Përvoja e zotit Serti shtrihet dhe në Raiffeisen Bank International. Ai mban pozicionin e Drejtuesit të Kullës së Teknologjisë që nga viti 2016, në të cilin është përgjegjës për rrjetin—duke çuar përpara teknologjinë e inovacionit të rrjetit për Raiffeisen Bank International dhe të 13 Njësitë e Raiffeisen Bank në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Z. Serti është diplomuar për Inxhinieri Elektronike – Shkenca Kompjuterike në Universitetin Politeknik të Tiranës. Ai gjithashtu ka një master në Administrim Biznesi nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Vilma Baçe - Anëtare e Bordit Drejtues për Biznesin Retail

Znj. Baçe është Anëtare e Bordit Drejtues për Biznesin Retail prej muajit prill 2022. Ajo ka një përvojë 18-vjeçare në sistemin bankar dhe njohuri të thella për biznesin Retail. Në periudhën maj 2016-mars 2022 znj. Baçe ka mbajtur pozicionin e Drejtores së Divizionit të Shitjeve dhe Rrjetit të Degëve në Raiffeisen Bank, ku ka menaxhuar në mënyrë efektive degët, shitjet direkte dhe marrëdhëniet me palët e treta, aspektin operacional dhe të shitjeve, me fokus të vazhdueshëm ofrimin e një shërbimi me cilësi të lartë dhe një imazh profesional të bankës.

Znj. Baçe u bë pjesë e Raiffeisen Bank në vitin 2004 si Drejtore për Marrëdhëniet me Publikun dhe Sponsorizimet. Në këtë pozicion ajo ka qenë përgjegjëse për vendosjen e marrëdhënieve të mira me komunitetin, pushtetin vendor e qendror, pozicionimin e Bankës si lider në vendin tonë. Znj. Baçe ka mbajtur edhe pozicionin e Anëtares së Këshillit të Administrimit të Raiffeisen Invest nga viti 2016 deri në mars 2022.

Gjithashtu, znj. Baçe ka pasur një përvojë menaxheriale në Bankën Kombëtare të Greqisë si Drejtore për Marrëdhëniet me Publikun dhe Marketingut, ku ka qenë përgjegjëse për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të biznesit Retail.

Përvoja e znj. Baçe në fushën ekonomike është pasuruar edhe me përfshirjen e saj në mësimdhënie. Ajo ka qenë lektore në Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Tiranës për lëndën “Bazat e mendimit ekonomik”. Gjithashtu, znj. Baçe ka mbuluar gazetarinë ekonomike pranë grupeve të ndryshme mediatike në Shqipëri.

Znj. Baçe është diplomuar për Ekonomi në Universitetin e Tiranës dhe ka kryer studimet pasuniversitare në ekonomi dhe gazetari ekonomike pranë Universitetit të Misurit, SHBA. Gjithashtu ajo ka kryer trajnime të ndryshme profesionale në fushën e menaxhimit strategjik, shërbimit të klientit, leadershipit, komunikimit, vijimësisë së biznesit, etj.

